



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 09 -2009
Prishtinë, më 23 mars 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj Bajram Kosumi, Kolë Berisha Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branislav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: dr. Arsim Gërxhaliu – Zyra për Persona të Zhdukur, Bedri Bahtiri – Ministria e Drejtësisë, dr Naim Haliti - Instituti i Mjekësisë Ligjore, Mimoza Ahmetaj - Komisioni për Shëndetësi i RK-ës, Alan Robinson - EULEX, Florie Hajra - Policia e Kosovës, Ardian Mehmetaj - Ministria e Shëndetësisë, Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti dhe Blerina Uka - NDI, Lejla Selimi OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Fidan Sylejmani - TV Rrokum dhe Vlora Marmullaku – EULEX.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 marsit 2009;

3. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore;
4. Të ndryshme.

Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit, ekspertët e fushës së mjekësisë ligjore dhe mjetet e informimit, për pjesëmarrje në këtë mbledhje pune, që nuk do të quhet dëgjim publik, sepse dëgjimi publik më shumë kërkon kohë. Qëllimi i këtij takimi, lidhur me themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, është që ne si Komision t'i marrim vërejtjet dhe komentet e dorës së parë të ekspertëve.

E dini se Komisioni e ka miratuar në parim këtë projektligj me disa vërejtje që janë trajtuar edhe në seancë plenare. Sot do të diskutojmë për tri çështje me rëndësi: përmbajtja, buxheti, dhe dispozitat e EULEX-it të nenit 8 të këtij projektligji, që ka të bëjë me bashkëkryesuesin e EULEX-it.

Kërkoj nga anëtarët e Komisionit që s'pari fjalën ta marrin ekspertët dhe për këtë çështje hapi debat.

Z. Bedri Bahtiri - përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë - Foli për rëndësinë e këtij projektligji që e përcakton strukturën e këtij departamenti dhe i harmonizon edhe institucionet e tjera në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Projektligji do të ketë edhe implikime buxhetore, por jo edhe aq të mëdha. Paraqiti nevojën e blerjes së laboratorit për analiza të ADN-së, sepse këto analiza tash për tash kryhen jashtë Kosovës. Sa u përket dispozitave të EULEX-it, meqë kemi mungesë të kuadrove, përfaqësuesit e EULEX-it duhet të jenë në rolin këshillëdhënës dhe jo në atë vendimmarrës.

Znj. Mimoza Ahmetaj - deputete dhe përfaqësuese e Komisionit të Shëndetësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës - Pati vërejtje për dispozitat e EULEX-it, përkatësisht për nenin 8.1, të cilin ekspertët e EULEX-it do ta monitorojnë, do t'i udhëzojnë dhe do t'i këshillojnë ekspertët vendorë në Departament gjatë punës së tyre. Nëse ky nen mbetet kështu, do të mbetemi aty ku jemi tash dhe nuk do të ketë mjekë vendorë. Duhet të korrigjohen dhe të futen fjalët: *në bashkëpunimi me mjekët vendorë*.

Dr. Naim Haliti - drejtor i Institutit për Mjekësi Ligjore – Ministria e Shëndetësisë - Shtoi se kemi punuar një kohë të gjatë në këtë projektligj. Tash për tash në Kosovë ka mjekë ligjorë. Është e domosdoshme ta kemi laboratorin e ADN-së, sepse është i nevojshëm për çështje penale edhe për çështje civile, sepse paraqiten raste të shpeshta kur duhet të vërtetohet atësia. Sot, Kosova, këtë analizë e bënë në shtetet e rajonit. Kjo krijohen shpenzime të shumëfishta. Shtoi se në tekst duhet të përdoren fjalët “për bashkëveprues”. Gjithashtu tha të mos jenë dy drejtorë, njëri vendor dhe tjetri ndërkombëtar.

Dr Arsim Gërxhaliu - drejtor i Departamentit për Persona të Zhdukur - Diskutimin e tij e filloi me thënien se njeriu deri sa të vdesë është çështje e

shëndetësisë, ndërsa kur të vdesë është çështje e jurisprudencës. Zyra jonë e ka buxhetin të planifikuar, por EULEX-i i udhëheq komplet çështjet që i përkasin antropologjisë. Bashkëpunimi ynë me të është në nivel të kënaqshëm.

Alen Robinson – Zyra e Personave të Zhdukur – EULEX - Diskutoi për raportet e mira në Zyrën e Personave të Zhdukur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Tha se janë arritur shumë suksese falë stafit vendor. Jemi të hendikepuar, sepse nuk kemi gjetur staf vendor të antropologjisë. Megjithatë jemi të gatshëm që këtu t'i zhvillojmë kapacitetet mjeko-ligjore. Vuri në dukje, edhe pse nuk është paraparë në këtë projektligj, se do të ishte mirë që në të ardhmen të parashihet nga deputetët laboratorin i ADN-së, sepse nuk kushton shumë.

Yordan Sirakov – përfaqësues i EULEX-it - Shtoi se sot punohet me ekspertë të EULEX-it dhe me ekspertë vendorë. Edhe më tutje puna do të kryhet në grupe të përziera, përveç rasteve kur nuk ka ekspertë vendorë, sidomos për rastet kur kemi të bëjmë me çështje penale, që janë në kompetencë të posaçme e EULEX-it. Në këtë rast ekspertët do të jenë vetëm të EULEX-it.

Kryetari - Pas diskutimeve të ekspertëve të mjekësisë ligjore kërkoi nga të pranishmit të parashitrojnë pyetje për ekspertët.

Adem Salihaj - I përshëndeti ekspertët dhe shtoi se e kemi një projektligj më të mirë se herën e parë. Si ka mundësi që Ministria ta ketë hartuar Projektligjin dhe a janë llogaritur më parë shpenzimet buxhetore, sepse kjo çështje mbetet e pasqaruar? Shtoi se çështja e bashkëkryesuesit është kushtetuese. Mendoj se me Kushtetutë kjo nuk lejohet.

Armend Zemaj - Përshëndeti të pranishmit dhe u përqendrua te përkufizimet për persona të zhdukur. Për konfliktin kam dilema se a mendohet vetëm për pasoja të konfliktit dhe të luftës. Shtroi edhe një pyetje për përfaqësuesit e forenzikës se a janë konsultuar për përgjegjësitë të zhvillimit të hetimeve të Divizionit të neni 6. Qartë duhet përkufizohet edhe roli i bashkëkryesuesit në këtë projektligj, ndërsa sa u përket shpenzimet buxhetore, do të sigurohen.

Adem Hajdaraj - Ngriti çështjet e mjeteve financiare, pas bashkimit të departamenteve dhe të blerjes së laboratorit për analiza të ADN-së, me qëllim që ato të kryhen në vendin tonë.

Ibrahim Makolli - U ndal te çështja e përkufizimit të personave të zhdukur. Pyeti se a do të hyjnë në këtë kategori edhe personat e zhdukur para dhe pas luftës apo vetëm kategoria e të zhdukurve në luftë. Përmendi edhe rolin e bashkëkryesuesve. Mendon se ka kaluar koha e tyre, sepse jemi në vitin 2009. Bashkëkryesuesit kanë dhënë kontribut në fillim të krijimit të institucioneve, pa e zhvlerësuar edhe rolin e EULEX-it.

Bajram Kosumi - Paraqiti vërejtjet e ngritura edhe në Komision. Shtoi se ato u sqaruan nga ekspertët. Vërejtja e parë ishte për buxhetin, sepse nuk mund të funksionojë ligji pa buxhetin e nevojshëm. Laboratori i ADN-së nuk është përfshirë në Projektligj. Është mirë që Komisioni të kërkojë nga Ministria e Drejtësisë që mjetet të sigurohen nëpërmjet rishikimit të buxhetit.

Bedri Bahtiri - Shtoi se në ligj nuk duhet t'i jepet kompetencë bashkëkryesuesit. I dëgjuat ekspertët tanë se kemi mungesë të kuadrove, p.sh. të antropologëve. Në tërë Projektligjin është thënë se kur është e mundur shpenzimet buxhetore duhet të sigurohen nëpërmjet rishikimit të buxhetit. Mendon se fjala konflikt është gabim teknik.

Arsim Gërxhaliu - Nuk duhet të ketë ndarje në persona të zhdukur gjatë luftës, por duhet të përfshihen edhe personat e tjerë të zhdukur në çdo kohë. Vuri në dukje edhe bashkëpunimin me Njësinë e Forenzikës, që është shumë i mirë. Foli edhe për shkollimin e kuadrove të laboratorit të ADN-së, që kushton shumë shtrenjtë. Ai që punësohet te ne për këtë punë merr 250 euro pagë.

Naim Haliti – Ekzistojnë vijat buxhetore për të dy institucionet. Në Institutin e Mjekësisë Ligjore frekuentojnë edhe studentë të mjekësisë dhe të juridikut. Shtoi se në tekst duhet të futen fjalët *personat e zhdukur para dhe pas luftës*.

Kryetari i përmbledhi rekomandimet që dolën nga ky takim:

*Përdorimi i termit konflikt nuk është gabim teknik. Edhe pse e dimë se ishte luftë, ndërkombëtarët kanë ngulur këmbë që të përdorej fjala konflikt.
Buxhetit është çështje e procedurave. Komisioni për buxhet duhet ta bëjë deklaratën financiare për implikime buxhetore.
Dispozitat e EULEX-it edhe ekspertët pajtohen që të ketë bashkëkryesues të EULEX-it.*

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni